

**STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**ABA FTE**

**Data 07.05.2024**



<b>TABELA E LËNDËS KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>4</b>
<b>NËNI 1.01 PËRKUFIZIME .....</b>	<b>4</b>
<b>KREU II. ORGANIZIMI I SHOQËRISË .....</b>	<b>4</b>
<b>NËNI 2.01 THEMELIMI I SHOQËRISË .....</b>	<b>4</b>
<b>NËNI 2.02 STRUKTURA E SHOQËRISË .....</b>	<b>5</b>
<b>NËNI 2.03 EMËRTIMI .....</b>	<b>5</b>
<b>NËNI 2.04 OBJEKTI I VEPRIMTARISË .....</b>	<b>5</b>
<b>NËNI 2.05 KOHËZGJATJA .....</b>	<b>5</b>
<b>NËNI 2.06 VENDI I USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË .....</b>	<b>6</b>
<b>NËNI 2.07 VULA .....</b>	<b>6</b>
<b>NËNI 2.08 DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE SHOQËRITË E KONTROLLUARA .....</b>	<b>6</b>
<b>KREU III. ORTAKU I VETËM .....</b>	<b>6</b>
<b>NËNI 3.01 ORTAKU I VETËM .....</b>	<b>6</b>
<b>NËNI 3.02 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>6</b>
<b>NËNI 3.03 KOMPETENCAT .....</b>	<b>6</b>
<b>NËNI 3.04 THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>6</b>
<b>KREU IV. ADMINISTRATORI .....</b>	<b>7</b>
<b>NËNI 4.01 EMËRIMI .....</b>	<b>7</b>
<b>NËNI 4.02 SHKARKIMI DHE DORËHEQJA .....</b>	<b>7</b>
<b>NËNI 4.03 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT .....</b>	<b>7</b>
<b>NËNI 4.04 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT .....</b>	<b>8</b>
<b>KREU V. KAPITALI I REGJISTRUAR .....</b>	<b>8</b>
<b>NËNI 5.01 VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TË REGJISTRUAR .....</b>	<b>8</b>
<b>NËNI 5.02 ZMADHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR .....</b>	<b>8</b>
<b>NËNI 5.03 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR .....</b>	<b>8</b>
<b>KREU VI. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR .....</b>	<b>9</b>
<b>NËNI 6.01 DIVIDENDI .....</b>	<b>9</b>
<b>NËNI 6.02 KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR .....</b>	<b>9</b>
<b>KREU VII. BUXHETI .....</b>	<b>9</b>
<b>NËNI 7.01 BUXHETI .....</b>	<b>9</b>
<b>NËNI 7.02 LIBRAT E SHOQËRISË DHE PËRPUTHSHMËRIA .....</b>	<b>9</b>
<b>KREU VIII. TË NDRYSHME .....</b>	<b>10</b>
<b>NËNI 8.01 VEÇUESHMËRIA .....</b>	<b>10</b>
<b>NËNI 8.02 LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM .....</b>	<b>10</b>
<b>NËNI 8.03 PRISHJA DHE LIKUIDIMI .....</b>	<b>10</b>

NENI 8.04 NJOFTIMET ..... 10

**LISTA E ANEKSEVE**

Aneks 1- Asetet



## KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1.01 Përkufizime

Fjalët e përdorura në këtë Statut me germa kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë :

“**Data e Nënshkrimit**” është data në të cilën është nënshkruar ky Statut.

“**Ditë të Plota**” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

“**Legjislacioni i Zbatueshëm**” do të thotë çdo ligj, akt nënligjor, akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, çdo vendim gjyqësor apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo personi të krijuar me ligj, (qoftë i pavaruar apo jo), që ka juridiksionin përkatës, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.

“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.

“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**” ose “**Ligji**” është ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.

“**Ortaku i Vetëm**” ka kuptimin e dhënë te Neni 3.1 (*Ortaku i Vetëm*).

“**Qendra Kombëtare e Biznesit**” ka kuptimin e institucionit sipas ligjit nr. 9723 datë 3.5.2007 “*Për regjistrimin e biznesit*” i ndryshuar, si dhe çdo institucion tjetër që në të ardhmen mund të marrë kompetencat e këtij institucioni.

“**Shoqëria**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 2.03 (*Emërtimi*) i këtij Statuti.

“**Statuti**” ka kuptimin e këtij Statuti.

## KREU II. ORGANIZIMI I SHOQËRISË

### Neni 2.01 Themelimi i Shoqërisë

Ortaku i Vetëm miraton themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për qëllimet dhe brenda fushës së zbatimit të përcaktuar nga ky Statut. Ortaku i Vetëm do të paraqesë menjëherë dokumentet e nevojshme në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në lidhje me formimin dhe funksionimin e Shoqërisë, siç mund të kërkohej ose është e përshtatshme sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

## **Neni 2.02 Struktura e Shoqërisë**

Shoqëria do të organizohet në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Organet e shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori.

## **Neni 2.03 Emërtimi**

Emri i shoqërisë do të jetë “**ABA FTE**” (“**Shoqëria**”). Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin, nën çdo emër tjetër për të cilin është rënë dakord nga Asambleja e Përgjithshme.

## **Neni 2.04 Objekti i Veprimtarisë**

- (a) Shoqëria do të kryejë në territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj aktivitetin e mëposhtëm:
- (i) Themelimi dhe krijimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja, si dhe pjesëmarrja në to, administrimi dhe drejtimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjeve vendase apo të huaja, të cilat ushtrojnë aktivitete në fushën e energjisë dhe vecanerisht ndertimi, mirembajtja, dhe operimi i infrastrukturave dhe kapaciteteve të nevojshme në funksion të krijimit të njesive prodhuese të energjisë dhe ushtrimit të aktiviteteve të mesiperme, përfshirë hidrocentrale, termocentrale, stacione elektrike, nen-stacione elektrike, linja të transmetimit të energjisë, sisteme diellore fotovoltaike, sisteme eolike, dhe strukturave, impiante, pajisje, e linja teknologjike të tjera kryesore apo ndihmëse; Marrja pjesë në shoqëri e bashkime shoqërisht të themeluara apo në themelim të sipër, në çdo formë të parashikuar nga Ligji që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, apo pjesëmarrje të tjera, që i shërbejnë rritjes së mëtejshme dhe arritjes së qëllimeve të Shoqërisë;
  - (ii) Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë (A) çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme, si dhe të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, përfshirë titujt, të vendosë pengje dhe barrë hipotekare mbi kuota/aksione të shoqërive të krijuara ose ku ajo është pjesëmarrëse; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë, dhe të shoqërive e sipërmarrjeve të themeluara/krijuara, apo në të cilat Shoqëria fiton pjesëmarrje si dhe (B) çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji.
- (b) Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti dhe çdo lloj operacioni ekonomik, juridik e financiar si dhe çdo operacion biznesi, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe për të favorizuar atë, Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

## **Neni 2.05 Kohëzgjatja**

- (a) Fillimi. Shoqëria do të fillojë veprimtarinë në datën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare Shqiptare të Biznesit, me kusht që të plotësohen kërkesat e themelimit të përcaktuara në Nenin 2.01 (*Themelimi i Shoqërisë*).

- (b) Kohëzgjatja. Kohëzgjatja e Shoqërisë do të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, ose deri në prishjen e Shoqërisë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimeve të marra në bazë të tij, ose kur parashikohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm.

#### **Neni 2.06 Vendi i ushtrimit të veprimtarisë**

- (a) Selia. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali I II-te”, Ndertesa nr. 12, “ABA Business Center”, kati i 7-te teknik. Njesia Administrative nr. 2, Tirane, Shqiperi.

Të dhënat kadastrale të pasurisë së paluajtshme ku ndodhet Selia janë: Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit “Njësi”, regjistruar ne ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212

#### **Neni 2.07 Vula**

Shoqëria ka vulën e saj mbi të cilën ka të shkruar emërtimin e saj tregtar.

#### **Neni 2.08 Degët, Zyrat e Përfaqësimit dhe Shoqëritë e Kontrolluara**

Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi dhe shoqëri të kontrolluara brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

### **KREU III. ORTAKU I VETËM**

#### **Neni 3.01 Ortaku i Vetëm**

Shoqëria është themeluar nga ortaku i vetëm **Gener 2 SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me NUIS K58615301M dhe me adresë në Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa nr 12, ABA Business Center, Tiranë (“**Ortaku i Vetëm**”).

#### **Neni 3.02 Asambleja e Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme do të jetë autoriteti më i lartë i Shoqërisë.

#### **Neni 3.03 Kompetencat**

Asambleja e Përgjithshme do të realizojë të gjithë të drejtat dhe do të përmbushë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga neni 81 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë do të marrë vendimet e duhura për Shoqërinë dhe do të mandatojë administratorin e saj ose këdo person tjetër, sipas rastit, që të ekzekutojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

#### **Neni 3.04 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

- (a) Thirrja nga Administratori. Kur Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori, ajo thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (e-mail) drejtuar

Asamblesë së Përgjithshme me kërkesë për konfirmim. Ky njoftim duhet të përcaktojë kohën, vendin, rendin e ditës, vendimet e propozuara së bashku me materialet mbështetëse si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga Ligji për Shoqëritë Tregtare. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur Asambleja heq dorë nga kryerja e njoftimit.

- (b) Shpeshësia e Mbledhjeve. Asambleja e Përgjithshme thirret me iniciativën e vet si dhe nga administratori, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit.
- (c) Kryetari i Mbledhjes. Administratori i Shoqërisë kryeson mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe cakton një person për të mbajtur procesverbalin e saj. Nëse administratori mungon, mbledhja kryesohet nga administratori i Ortakut të Vetëm.
- (d) Vendi. Mbledhjet do të mbahen në selinë e Shoqërisë apo me mjete elektronike siç do të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme.

#### KREU IV. ADMINISTRATORI

##### Neni 4.01 Emërimi

- (a) Administratori i Parë. Shoqëria do të administrohet në aktivitetet e administrimit të zakonshëm nga Administratori. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë **Z. Lorin Ymeri**, shtetas Shqiptarë, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Bulevardi "Bajram Curri"; nr. 110; Pallati "Palma e Arte"; Tiranë; 1000, Shqipëri; lindur më 30.08.1984, me Leternjoftim ID nr. personal I40830061G.
- (b) Mandati. Administratori emërohet për një periudhë kohore prej 5 (pese) vitesh.

##### Neni 4.02 Shkarkimi dhe Dorëheqja

- (a) Shkarkimi. Administratori mund të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë me ose pa shkak, sa herë që sipas gjykimit të Asamblesë së Përgjithshme do të përmbushen interesat më të mira të Shoqërisë.
- (b) Dorëheqja. Administratori mund të japë dorëheqjen duke njoftuar me shkrim Asamblesën e Përgjithshme. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë njoftim, dorëheqja do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit të tillë nga Asambleja e Përgjithshme dhe pranimi i dorëheqjes nuk do të jetë i nevojshëm për ta bërë atë efektive.

##### Neni 4.03 Kompetencat e Administratorit

- (a) Përfaqësimi i Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet në marrëdhënien me të tretët nga Administratori. Administratori do të ketë çdo kompetencë që Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti nuk ja ngarkon Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë mund të kufizojë me vendim kompetencat e Administratorit në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- (b) Zëvendësimi i Administratorit. Administratori mund të autorizojë rast pas rasti persona të tjerë për kryerjen e detyrave të caktuara.

- (c) Menaxhimi i Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë punët e përditshme të biznesit të Shoqërisë në përputhje me këtë Statut dhe parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

#### **Neni 4.04 Shpërblimi i Administratorit**

Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Ortaku i Vetëm në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

### **KREU V. KAPITALI I REGJISTRUAR**

#### **Neni 5.01 Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar**

- (a) Kapitali i regjistruar. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 102,000 (njqind e dy mije) Euro ose ekuivalenti në leke në vlerën prej 11,900,940 (njembedhjetë milion e nenteqind mije e nenteqind e dyzet) Lekë dhe përfaqësohet nga 1 (një) kuotë, e cila zotërohet 100 % nga Ortaku i Vetëm.
- (b) Kontributet. Kontributi i Ortakut të Vetëm në kapitalin e Shoqërisë përbëhet në formën e kontributit në natyrë nga kuota që zotëron në shoqërinë bijë të saj (“**Kontributi në natyrë**”). Kontributi në natyrë dhe vlera e saj sipas zërave dhe në total përcaktohen në Aneksin 1 (*Kontributi në natyrë*) të këtij Statuti në përputhje me vlerësimin e vlerës së kontributit në natyrë të bërë nga Ortaku i vetëm në kapitalin e Shoqërisë sipas përcaktimeve të Nenin 68, pika 6, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### **Neni 5.02 Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar**

- (a) Zmadhimi i Kapitalit. Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet nëpërmjet kontributeve në para, kontributeve në natyrë, ose nëpërmjet përfshirjes së rezervave apo fitimit në kapitalin e regjistruar.
- (b) Format. Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë:
- (i) duke rritur proporcionalisht vlerën e kuotës së Ortakut të Vetëm në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës;
  - (ii) duke pranuar kontribute nga një ortak i ri në Shoqëri.
- (c) Për të dy rastet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, Ortaku i Vetëm miraton zmadhimin e kapitalit me vendim.

#### **Neni 5.03 Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar**

- (a) Zvogëlimi i Kapitalit. Ortaku i Vetëm mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë me vendimin e Ortakut të Vetëm.
- (b) Format. Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet duke ulur proporcionalisht vlerën e kuotës së Ortakut të Vetëm në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës.



## KREU VI. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR

### Neni 6.01 Dividendi

- (a) Shpërndarja e Dividendit. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të shpërndajë dividendin dhe mund të vendosë në lidhje me fitimet që rezultojnë nga bilanci, vetëm nëse pas pagimit të dividendit aktivet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e saj dhe Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve në vijim.
- (b) Deklarimi i Dividendit. Dividendi deklarohet dhe paguhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuota për të cilën paguhet dividendi.
- (c) Rezervat Private. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për krijimin e rezervave nga fitimet vjetore.

### Neni 6.02 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin e Regjistruar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të Shoqërisë.

## KREU VII. BUXHETI

### Neni 7.01 Buxheti

- (a) Miratimi i Buxhetit. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para çdo viti fiskal, Administratori do t'i dorëzojë Asamblesë së Përgjithshme një buxhet të propozuar për vitin e ardhshëm fiskal, i cili do të jetë në formën dhe detajet e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Ky buxhet i propozuar do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- (b) Informacione të tjera financiare. Administratori gjithashtu do t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme raporte të tjera (financiare ose jo) dhe buxhete që Asambleja e Përgjithshme mund të kërkojë herë pas here.

### Neni 7.02 Librat e Shoqërisë dhe Përputhshmëria

- (a) Librat dhe Dokumentet e Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë ose do të bëjë që të mbahen librat dhe regjistrimet e duhura sipas Legjislacionit të Zbatueshëm në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë. Librat dhe dokumentet e Shoqërisë do të mbahen në çdo kohë në selinë ligjore të Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë në selinë e saj sa vijon:
  - (i) një kopje të këtij Statuti dhe të gjitha ndryshimet e tij;
  - (ii) kopjet e deklaratave tatimore dhe raporteve të Shoqërisë, nëse ka, për tre (3) vitet më të fundit fiskale;

- (iii) kopjet e çdo pasqyre financiare, nëse ka, të Shoqërisë për pesë (5) vitet më të fundit fiskale; dhe
  - (iv) dokumente të tjera në lidhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme herë pas here me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- (b) Pajtueshmëria. Shoqëria do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të marrë dhe mbajtur në fuqi dhe të për të zbatuar të gjitha miratimet, pëlqimet ose licencat e nevojshme për zhvillimin dhe përmbushjen e objektit të veprimtarisë.

## **KREU VIII. TË NDRYSHME**

### **Neni 8.01 Veçueshmëria**

Termat, kushtet dhe dispozitat e këtij Statuti janë plotësisht të ndashme dhe vendimi ose aktgjykimi i çdo gjykate të juridiksionit kompetent që e bën të pavlefshëm ose të pazbatueshëm një ose më shumë nga këto kushte, kushte ose dispozita nuk do të bëjë të pavlefshëm ose të pazbatueshëm termat, kushtet ose dispozitat e këtij Statuti dhe një term i tillë i pavlefshëm ose i pazbatueshëm do të zëvendësohet me një term të vlefshëm dhe të zbatueshëm, i cili do të pasqyrojë në masën më të madhe të mundshme synimet origjinale të Ortakut të Vetëm.

### **Neni 8.02 Legjislacioni i Zbatueshëm**

Ky Statut në të gjitha aspektet do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Për aq sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Kodit Civil Shqiptar, si dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 8.03 Prishja dhe Likuidimi**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të Ortakut të Vetëm gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes.

### **Neni 8.04 Njoftimet**

Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresat e mëposhtme:

Njoftimi nga Administratori drejt Asamblesë së Përgjithshme: [info@gener2.al](mailto:info@gener2.al)

Njoftimi nga Asambleja e Përgjithshme drejtuar Administratorit: [info@gener2.al](mailto:info@gener2.al)

**Ortaku i Vetëm/Gener 2 SHPK**  
Përfaqësuar nga Administratori  
Artilla Ulaj

**Kontributi në Natyrë**

**Ortaku i vetëm "GENER 2" SH.P.K.**

Kapitali fillestar i Shoqërisë "ABA FTE", do të përbëhet nga kontributi në natyrë: përkatësisht aksionet që Ortaku i vetëm, Shoqëria "GENER 2" sh.p.k. zotëron në Shoqërinë Bijë, te saj: „**FIER THERMOELECTRIC**” SH.A., regjistruar si person juridik ne QKB (Qendren Kombetare te Biznesit) me numer identifikimi te subjektit NUIS Nr. M22211019U, dhe me adrese te regjistruar ne Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga "Papa Gjon Pali I II-te", Ndertesa nr. 12, ABA Business Center, Kati I 7-te, nr pasurie 7/52-N9, ZK 8160, vol 36, faqe 212, Tirane.


Kontributi është vlera e aksioneve që Shoqëria "GENER 2" sh.p.k. zotëron në kapitalin e Shoqërisë „**FIER THERMOELECTRIC**” SH.A., përkatësisht **300 aksionenë** vlerën prej 102,000 (njqind e dy mije) Euro ose ekuivalenti ne leke ne vleren prej 11,900,940 (njembedhete milion e nenteqind mije e nenteqind e dyzet) Lekë, e cila përbën 30 % të kapitalit të Shoqërisë „**FIER THERMOELECTRIC**” SH.A..

**Ortaku i Vetëm**

**Gener 2 SHPK**

Përfaqësuar nga Administratori

Artila Ulaj



**GENER 2**  
NUIS: K58615301M